



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 41, paragrafët 41.1 dhe 41.2 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), dhe nenit 36 paragrafi 36.1 i Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.01.2018, merr këtë

**V E N D I M  
P Ë R**

**ZGJEDHJEN E KRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS**

- I. **MIRATOHET** Vendimi për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.
- II. Kryesues i Kuvendit, sipas pikës I të këtij vendimi, zgjidhet **Agim Kuleta**, nga Prishtina.
- III. Mandati i kryesuesit zgjat katër vjet, respektivisht deri më inaugurimin e Kuvendit të ardhshëm, në pajtim me dispozitat e Ligjit për zgjedhjet lokale në fuqi.
- IV. Punët dhe detyrat e kryesuesit të Kuvendit janë të parapara me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Udhëzimin administrativ nr. 2009/01, për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Statutin e Komunës së Prishtinës.
- V. Paga e të përmendurit në pikën II të këtij vendimi, në shumë prej 605.00 €, si pagë bruto mujore, i është llogaritur në pajtim me dispozitat e Udhëzimit administrativ nr. 2008/16, për pagesën e stafit politik në komuna.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes së tij.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-112/06-23973/18, më 30.01.2018

**KRYESUESI I Mbledhjes së Kuvendit**

